



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE  
DHE EKONOMISË

AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE  
SHKOLLA TEKNIKE EKONOMIKE TIRANË

Nr. 967 Prot.

Tiranë, më 25/09/2023

Lënda: Njoftim për vend të lirë

**DREJTORISË SË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE  
DREJTORISË Ë MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN  
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”; të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive”; të Udhëzimit Nr. 14, datë 27.5.2021, Për Mënyrën e Organizimit dhe Veprimtarinë e Ofruesve Publikë të Arsimit dhe Formimit Profesional”, Neni 113, pika “e” shkolla Teknike Ekonomike Tiranë ju njofton krijimin e vendit të lirë për vitin shkollor 2023- 2024 në pozicionet:

1. 2 ( dy) mësimedhenes të kultures profesionale (teori dhe praktike profesionale me kohe e plote në drejtimin Ekonomi-Biznes ,te diplomuar në profilet :Ekonomiks : Informatikë Ekonomike : Marketing,Profili Administrim Zyre

1. Kriteret e marrjes në punë:

2.1 Kriteret të përgjithshme:

- të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

2.2 *Kritere të posaçme për personelin mësimdhënës të teorisë profesionale në ofruesit e AFP-së, që ofrojnë arsim të mesëm profesional:*

- a) të ketë diplomë të nivelit master professional ose të barasvlershme, në të njëjtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së;
- b) të ketë të paktën 3 (tre ) vit përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;

2. Dokumentet e aplikimit:

- a) letërmotivimin për pozicionin;
- b) jetëshkrimin (CV-në),
- c) kartën e identitetit;
- d) diplomën;
- e) librezën e punës;
- f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- g) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- h) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- i) vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- j) vërtetim nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
- k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënës të mëparshëm.

2. Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Dokumentet në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuara.

3. Afati përfundimtar i dorëzimit të dokumentacionit në protokollin e shkollës Teknike Ekonomike Tiranë është 11/10/2023

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

